

Shërbimi i
Leancos Plenar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Nr. 3977 Prot.

Tiranë, më 14.09.2026

Lënda: Kërkesë për interpelancë urgjente me Ministren e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale, Znj. Klodiana Spahiu

Drejtuar: Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë
Z. Niko Peleshi

Baza Ligjore: Në mbështetje të pikës 1 të nenit 80 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe nenit 97 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.

Këtu,

Nisur nga deklaratat e fundit të Kryemnistrit Rama të cilat konfirmojnë krijimin e Operatorit të Shërbimeve të Integruara Shëndetësor, si një super-strukturë e cila do të administrojë jo vetëm koncesionet e shëndetësisë por dhe furnizimet e barnave dhe shërbime të tjera të sistemit shëndetësor. Pretendimi i justifikuar nga vetë kryeministri se kjo super agjenci do të centralizojë një sërë shërbimesh të sistemit shëndetësor për të luftuar korrupsionin është e pabazë, pasi në realitet do të jetë jashtë nga cdo lloji transparence e llogaridhënie përfshirë atë parlamentare.

Ky është një vendim politik i mirë menduar i cili është bërë plotësisht jashtë vëmendjes së publikut dhe jashtë cdolloji transparence institucionale. Në fillim nëpërmjet VKM nr 629 datë 30.07.2026 u ndryshuar emërtimi nga “Operatori i Shërbimeve të Integruara të Sterilizimit” e cila ishte krijuar më herët me VKM nr 845 datë 30.12.2025, në “Operatori i Shërbimeve të Integruara Shëndetësore”. Kjo shoqëri aksionere sipas VKM do të administrojë koncesionet e hemodializës, kontrollit bazë mjekësor dhe sterilizimit. Por nuk u ndal vetëm me kaq, pasi sipas deklaratave të Kryemnistrit Rama kjo super-strukturë do të marrë në menaxhim të gjithë shërbimet jetike të sistemit shëndetësor.

Në mungesë llogaridhënie dhe transparence, krijimi i kësaj shoqërie, ku kompetenca që sot janë të ndara mes disa institucioneve bëhet njëkohësisht blerës, depo qendrore, operator logjistik, administrator i rezervave dhe krijon kompani bija. Kjo ngre pikëpyetje serioze juridike për tejkalimin apo mbivendosjen e kompetencave që ligji u ka dhënë institucioneve si Ministria e Shëndetësisë, FSDKSH, AKBPM dhe Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Ne vlerësojmë se sistemi shëndetësor nuk mund të funksionojë mbi një model ku blerja, magazinimi, logjistika, furnizimi dhe administrimi i shërbimeve jetike përqendrohen në një dorë të vetme. Ndaj Ministria e Shëndetësisë do të duhet të sqarojë urgjentisht bazën ligjore, kompetencat, fondet dhe mekanizmat e kontrollit që do të ketë kjo mega strukturë.

Poashtu me aq shqetësim vlerësojmë situatën në shërbimin onkologjik në rang kombëtar. Mungesa ose aksesit i kufizuar në trajtim terapeutik dhe diagnostikues bazë, si PET/CT skaner, akseleratorë, brakiterapi. Poashtu kapacitetet e pamjaftueshme të trajtimit, mungesa e shtretërve për hospitalizim dhe shërbim ambulator, si dhe problemet e vazhdueshme me disponueshmërinë e barnave, cenojnë drejtpërdrejt diagnostikimin dhe trajtimin në kohë të pacientëve me sëmundje tumorale.

Pavarësisht deklaratave publike të drejtuesve të Ministrisë së Shëndetësisë për plotësimin brenda këtij viti të nevojave urgjente për PET/CT, akseleratorë linearë dhe brakiterapi në sistemin shëndetësor publik, gjendja vijon të mbetet e pandryshuar. Mungesa e këtyre pajisjeve dhe shërbimeve vazhdon të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në funksionimin e Shërbimit Onkologjik në QSUT dhe në trajtimin e pacientëve në të gjithë vendin.

Një tjetër problematikë serioze lidhet me mungesën e programeve të mjaftueshme dhe efektive të depistimit dhe diagnostikimit të hershëm. Të dhënat më të fundit të GLOBOCAN-it, të publikuara nga Agjencia Ndërkombëtare për Kërkime mbi Kancerin pranë Organizatës Botërore të Shëndetësisë, mbi barrën e sëmundjeve tumorale dhe numrin e rasteve të reja të kancerit në Shqipëri, kërkojnë një analizë të thelluar të përputhshmërisë ndërmjet statistikave zyrtare kombëtare dhe situatës reale. Ato kërkojnë gjithashtu transparencë mbi kapacitetet e diagnostikimit të hershëm dhe mbi nivelin e financimit publik për parandalimin, diagnostikimin dhe trajtimin e këtyre sëmundjeve.

Të gjitha këto problematika dëshmojnë për mangësi strukturore në disa prej hallkave më kritike të sistemit shëndetësor. Në këto kushte, është e domosdoshme që Ministria e Shëndetësisë dhe

Mirëqenies Sociale të japë llogari për politikat e ndjekura, fondet e administruara dhe përgjegjësitë institucionale për këtë gjendje tejet shqetësuese.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 1 të nenit 80 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 97 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, kërkojmë zhvillimin e kësaj interpelance urgjente me Ministren e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Kjo interpelancë urgjente kërkohet në funksion të interesit më të lartë qytetar dhe të detyrimit të institucioneve publike për të garantuar transparencë, llogaridhënie dhe përdorim të përgjegjshëm të fondeve publike, veçanërisht në një sektor që lidhet drejtpërdrejt me mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të qytetarëve.

DEPUTETËT

Bourek Spahiu
Jenide Todor

Elda Hoti

Arvan Garamet
Gazmet Barshi

Ngeli Cera

Desert Ruzhici

A collection of handwritten signatures in blue ink, corresponding to the names of the deputies listed on the left. The signatures are written in a cursive, stylized manner. Some signatures are more prominent and larger than others, such as the one for Bourek Spahiu.